



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 58 dt.08.05.1995

**MBI**  
**KRIJIMIN E ORKESTRËS FRYMORE TE BASHKISË SE TIRANËS**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Kulturës në mbështetje të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

**VENDOSI**

1. Të krijohet orkestra frymore e Bashkisë e përbërë nga 43 orkestrant një dirigjent dhe një përgjegjës orkestre, gjithsej 45 vetë.
2. Orkestrantët do të paguhën me gjysmën e vlerës së pagës së orkestrantëve, jashtë orarit të punës ndërsa dirigjenti dhe përgjegjësi i orkestrës do të jenë me pagë të plotë.
3. Për funksionimin e orkestrës frymore Seksioni i Kulturës do të hartoj një rregullore pune të veçantë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Seksioni i Kulturës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**